



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1183/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Besarta Bytyqi, vëzhguese nga radhët e PDK-së në Lipjan, paraqitur kundër Burim Neziri menaxher i vendvotimit, për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Besarta Bytyqi vëzhguese nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:57 nga Besarta Bytyqi vëzhguese e PDK-së ku ka pretenduar se në vendvotimin 1317e në fshatin Sllovi, komisionerët e PDK-së dhe menaxheri i vendvotimit (VV) Burim Neziri ka ndryshuar numrin e votave në FPR duke e dëmtuar Lumturije Bytyqin me afër 80 vota. Po ashtu, kërkoj nga ju rinumërimin e kësaj qendre të VV, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të vëzhgueses Besarta Bytyqi janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1183/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.